

# **Dhënie Informacionsh Shpjeguese—Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Pasiveve Financiare**

(Ndryshime në SNRF 7)

## Ndryshime në SNRF 7 Instrumentat Financiarë: Dhënie Informacionesh Shpjeguese

Pas paragrafit 13 janë shtuar një titull dhe paragrafët 13A–13F.

### Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare

- 13A Dhënia e informacioneve shpjeguese në paragrafët 13B–13E plotëson kërkesat e tjera për dhënie informacionesh shpjeguese të këtij SNRF dhe kërkohet për të gjitha instrumentat financiarë të njohur që shlyhen në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32. Kjo dhënie informacionesh shpjeguese zbatohet edhe për instrumentat financiarë të njohur që janë objekt i një marrëveshje detyruese për mbrojtjen nga rreziku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme, pavarësisht se ata mund të jenë shlyer në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32.
- 13B Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që t'u mundësojë përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë efektin ose efektin e mundshëm të marrëveshjes për mbrojtjen nga rreziku i derivativëve në pozicionin financiar të njësisë ekonomike. Kjo përfshin efektin ose efektin e mundshëm të të drejtave për kompensim që lidhen me aktivet dhe pasivet financiare të njohura, të cilat janë brenda objektit të paragrafit 13A.
- 13C Për të realizuar objektivin e paragrafit 13B, një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues sasior në vijim, në fund të periudhës së raportimit, veçmas për aktivet dhe pasivet financiare të njohura të cilat janë brenda objektit të paragrafit 13A:
- (a) shumat bruto të atyre aktiveve dhe pasiveve financiare të njohura;
  - (b) shumat që janë kompensuar në përputhje me kriterin e dhënë në paragrafin 42 të SNK 32 kur përcaktohen shumat neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar;
  - (c) shumat neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar;
  - (d) shumat objekt i një marrëveshje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 13C(b), përfshirë:
    - (i) shumat që lidhen me instrumentat financiarë të njohur të cilët nuk plotësojnë disa apo të gjitha kriteret e kompensimit të dhëna në paragrafin 42 të SNK 32; dhe
    - (ii) shumat që lidhen me garancitë financiare (përfshirë garancitë në mjete monetare); dhe
  - (e) shumën neto pas zbritjes së shumave të pikës (d) nga shumat e pikës (c) mësipër.
- Informacioni i kërkuar nga ky paragrafi duhet të paraqitet në formë tabele, veçmas për aktivet dhe pasivet financiare, përveç rastit kur është më i përshtatshëm një format tjetër.
- 13D Shuma totale për një instrument e paraqitur në përputhje me paragrafin 13C(d) duhet të kufizohet deri në shumën e paragrafit 13C(c) për atë instrument.
- 13E Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në dhënien e informacioneve shpjeguese një përshkrim të të drejtave për kompensim që lidhen me aktivet dhe pasivet financiare të njohura të njësisë ekonomike që janë objekt i një marrëveshje detyruese për mbrojtjen nga rreziku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme në përputhje me paragrafin 13C(d), duke përfshirë natyrën e këtyre të drejtave.
- 13F Nëse informacioni i kërkuar nga paragrafët 13B–13E paraqitet në më shumë se në një shënim shpjegues të pasqyrave financiare, njësi ekonomike do të kryqëzojë referencat mes këtyre shënimeve.

### Data e hyrjes në fuqi dhe dispozitat kalimtare

Është shtuar paragrafi 44R.

- 44R *Dhënie Informacionesh Shpjeguese—Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Pasiveve Financiare* (Ndryshime në SNRF 7), i publikuar në Dhjetor 2011, shtoi paragrafët IN9, 13A–13F dhe B40–B53. Një njësi ekonomike duhet t'i zbatojë këto ndryshime për periudhat ushtrimore që fillojnë më 1 Janar 2013 ose më pas dhe për periudhat ushtrimore të ndërmjetme brenda këtyre periudhave vjetore. Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga këto ndryshime në mënyrë retrospektive.

Pas paragrafit B39 janë shtuar tituj dhe paragrafët B40–B53.

## Kompensimi i aktiveve financiare dhe pasiveve financiare (paragrafët 13A–13F)

### Objekti (paragrafi 13A)

- B40 Dhënia e informacioneve shpjeguese në paragrafët 13B–13E kërkohet për të gjithë instrumentat financiarë të njohur që janë kompensuar në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32. Gjithashtu, instrumentat financiarë janë brenda objektit të kërkesave për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 13B–13E nëse ata janë objekt i një marrëveshje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme, pavarësisht se ata mund të jenë shlyer në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32.
- B41 Marrëveshjet e ngjashme të përmendura në paragrafët 13A dhe B40 përfshijnë marrëveshje kleringu për derivativët, marrëveshje riblerjeje të pergjithshme, marrëveshje bazë të huadhënies me letra me vlerë dhe çdo të drejtë tjetër që lidhet me garancitë financiare. Instrumentat financiarë të ngjashëm dhe transaksionet e përmendura në paragrafin B40 përfshijnë derivativët, marrëveshjet e shitjes dhe të riblerjes, marrëveshjet e kundërta të shitjes dhe të riblerjes, huamarrjen me letra me vlerë dhe marrëveshjet e huadhënies me letra me vlerë. Shembuj të instrumentave financiarë që nuk janë brenda objektit të paragrafit 13A janë huatë dhe depozitat e klientëve në të njëjtin institucion (me përjashtim të rastit kur ato janë kompensuar në pasqyrën e pozicionit financiar) dhe instrumentat financiarë që janë objekt vetëm i një marrëveshjeje garancie.

### *Dhënie informacionesh shpjeguese mbi informacionin sasior për aktivet dhe pasivet financiare të njohura brenda objektit të paragrafit 13A (paragrafi 13C)*

- B42 Instrumentat financiarë të paraqitur në përputhje me paragrafin 13C mund të jenë objekt i kërkesave të ndryshme të matjes (për shembull një llogari e pagueshme që lidhet me një marrëveshje riblerjeje mund të matet me koston e amortizuar, ndërsa një derivativ mund të matet me vlerën e drejtë). Një njësi ekonomike duhet të përfshijë në dhënien përkatëse të informacioneve shpjeguese, instrumentat me shumat e njohura të tyre dhe të përshkruajë çdo diferencë të rezultuar matjeje.

### *Dhënie informacionesh shpjeguese mbi shumat bruto të aktiveve dhe pasiveve financiare të njohura brenda objektit të paragrafit 13A (paragrafi 13C(a))*

- B43 Shumat e kërkuara nga paragrafi 13C(a) lidhen me instrumentat financiarë që janë kompensuar në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32. Shumat e kërkuara nga paragrafi 13C(a) lidhen edhe me instrumentat financiarë të njohur që janë objekt i një marrëveshje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme, pavarësisht nëse e plotësojnë kriterin e kompensimit. Megjithatë dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 13C(a) nuk lidhet me shumat njohura si pasojë e një marrëveshjeje garancie që nuk plotëson kriterin e kompensimit të paragrafit 42 në SNK 32. Për shumat të tilla kërkohet të jepen informacione shpjeguese në përputhje me paragrafin 13C(d).

### *Dhënie informacionesh shpjeguese mbi shumat që kompensohen në përputhje me kriterin e dhënë në paragrafin 42 të SNK 32 (paragrafi 13C(b))*

- B44 Paragrafi 13C(b) kërkon që njësitë ekonomike të japin informacione shpjeguese mbi shumat e kompensuara në përputhje me paragrafin 42 të SNK 32 kur përcaktojnë shumat neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar. Shumat e aktiveve dhe pasiveve financiare të njohura që janë objekt i kompensimit sipas të njëjtës marrëveshjeje do të paraqiten në dhënien e informacioneve shpjeguese për aktivet dhe pasivet financiare. Megjithatë shumat paraqitura (për shembull në një tabelë) do të kufizohen në madhësinë e shumave që janë objekt i kompensimit. Për shembull një njësi ekonomike mund të ketë një aktiv dhe një pasiv derivativ të njohur që plotëson kriterin në paragrafin 42 të SNK 32. Nëse shumat bruto e aktivit derivativ është më e madhe se shumata bruto e pasivit derivativ, tabela e dhënies së informacioneve shpjeguese për aktivin financiar do të përfshijë të gjithë shumën e aktivit derivativ (në përputhje me paragrafin 13C(a)) dhe të gjithë shumën pasivit derivativ (në përputhje me paragrafin 13C(b)). Megjithatë ndërsa tabela e dhënies së informacioneve shpjeguese për pasivin financiar do të përfshijë të gjithë shumën e pasivit derivativ (në përputhje me paragrafin 13C(a)), ajo do të përfshijë vetëm shumën e aktivit derivativ (në përputhje me paragrafin 13C(b)) që është barabartë me shumën e pasivit derivativ.

### *Dhënie informacionesh shpjeguese mbi shumat neto të paraqitura në pasqyrën e pozicionit financiar (paragrafi 13C(c))*

- B45 Nëse një njësi ekonomik ka instrumenta që plotësojnë objektin këtyre dhënieve të informacioneve shpjeguese (siç cilësohet në paragrafin 13A), por nuk plotësojnë kriterin për kompensim të paragrafit 42 të SNK 32, shumat që kërkohet të paraqiten sipas paragrafit 13C(c) duhet të jenë të barabarta me shumat që kërkohet të paraqiten sipas paragrafit 13C(a).

- B46 Shumat që kërkohet të paraqiten sipas paragrafit 13C(c) duhet të rakordohen me shumat individuale të zërave të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Për shembull, nëse një njësi ekonomike përcakton se grupimi ose ndarja e shumave individuale të zërave në pasqyrat financiare ofron informacion më të rendësishëm, ajo duhet të rakordojë shumat e grupuara ose të ndara të paraqitura në paragrafin 13C(c) me shumat individuale të zërave të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar.

*Dhënie informacionesh shpjeguese mbi shumat objekt i një marrëveshjeje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve ose marrëveshjeje të ngjashme të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 13C(b) (paragrafi 13C(d))*

- B47 Paragrafi 13C(d) kërkon që njësitë ekonomike të japin informacione shpjeguese mbi shumat që janë objekt i një marrëveshjeje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve ose një marrëveshjeje të ngjashme të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 13C(b). Paragrafi 13C(d)(i) i referohet shumave që lidhen me instrumentat financiarë të njohur të cilët nuk plotësojnë disa apo të gjitha kriteret e kompensimit të paragrafit 42 të SNK 32 (për shembull të drejtat aktuale për kompensim që nuk plotësojnë kriteret e paragrafit 42(b) të SNK 32, ose të drejtat e kushtëzuara që janë detyruese ose të ushtrueshme vetëm në rast paaftësie paguese ose falimentimi të njëjës prej palëve).
- B48 Paragrafi 13C(d)(ii) i referohet shumave që lidhen me garancinë financiare përfshirë garancinë në mjete monetare, të marrë apo të premtuar. Një njësi ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese mbi vlerën e drejtë të këtyre instrumentave financiarë të premtuar ose të marrë si garanci. Shumat e paraqitura në përputhje me paragrafin 13C(d)(ii) duhet të lidhen me garancinë aktuale të marrë ose premtuar dhe jo me ndonjë shumë të pagueshme ose të arkëtueshme që vjen si pasojë kthimit ose tërheqjes së garancisë.

*Kufizime mbi shumat e paraqitura në informacionet shpjeguese të paragrafit 13C(d) (paragrafi 13D)*

- B49 Gjatë dhënies së informacioneve shpjeguese në përputhje me paragrafin 13C(d), një njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë efektet e super-garancisë të instrumentit. Për t'a realizuar këtë njësi ekonomike duhet të zbrësë fillimisht shumat e paraqitura në përputhje me paragrafin 13C(d)(i) nga shuma e paraqitura në përputhje me paragrafin 13C(c). Më pas njësi ekonomike duhet të kufizojë shumat e paraqitura në përputhje me paragrafin 13C(d)(ii) në madhësinë e mbetur në paragrafin 13C(c) për instrumentin financiar përkatës. Megjithatë nëse të drejtat për garancinë mund të jenë detyruese nëpërmjet instrumentave financiarë, këto të drejta mund të përfshihen në dhënien e informacioneve shpjeguese në përputhje me paragrafin 13D.

*Përshkrimi i të drejtës për kompensim objekt i marrëveshjeje detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve dhe marrëveshjeje të ngjashme (paragrafi 13E)*

- B50 Një njësi ekonomike duhet të përshkruajë llojet e të drejtave për kompensim dhe marrëveshje të ngjashme të dhëna në informacionet shpjeguese në përputhje me paragrafin 13C(d), përfshirë natyrën e këtyre të drejtave. Për shembull një njësi ekonomike duhet të përshkruajë të drejtat e saj të kushtëzuara. Për instrumentat që janë objekt i të drejtave për kompensim jo të kushtëzuara nga një ngjarje e ardhshme por që nuk plotësojnë kriteret e mbetura në paragrafin 42 të SNK 32, njësi ekonomike duhet të përshkruajë arsyen(t) pse nuk plotësohen kriteret. Për çdo garanci financiar të marrë ose premtuar, njësi ekonomike duhet të përshkruajë kushtet e marrëveshjes së garancisë (për shembull, nëse garancia është e kufizuar).

*Dhënie informacionesh shpjeguese sipas tipit të instrumentave financiarë ose palës tjetër*

- B51 Dhënia e informacioneve shpjeguese e kërkuar nga paragrafi 13C(a)–(e) mund të grupohet sipas llojit të instrumentit financiar ose transaksionit (për shembull, derivativët, marrëveshjet e riblerjes ose marrëveshjet e huamarrjes dhe huadhënies së letrave me vlerë).
- B52 Si një alternativë tjetër një njësi ekonomike mund të grupojë dhënien e informacioneve shpjeguese sasiore të kërkuar nga paragrafi 13C(a)–(c) sipas llojit të instrumentit financiar dhe dhënien e informacioneve shpjeguese sasiore të kërkuar nga paragrafi 13C(c)–(e) sipas palëve të tjera. Nëse njësi ekonomike paraqet informacionin e kërkuar sipas palëve të tjera, nuk kërkohet që ajo të identifikojë emrat e palëve. Megjithatë përcaktimi i palëve (Pala tjetër A, Pala tjetër B, Pala tjetër C, etj) duhet të jetë i njëjtë nga viti në vit, për vitet e paraqitura që të sigurohet krahasueshmëria. Duhet të merret në konsideratë dhënia e informacioneve shpjeguese cilësore në mënyrë që të jepet informacion i mëtëjshëm lidhur me llojet e palëve të tjera. Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese mbi shumat në paragrafin 13C(c)–(e) sigurohet nga një palë tjetër, shumat që janë të rëndësishme veçmas kundrejt shumës totale të palës tjetër duhet të paraqiten veçmas dhe shumat e mbetura, të parëndësishme veçmas, duhet të bashkohen në një zë të vetëm.

*Të tjera*

- B53 Dhëniet e informacioneve shpjeguese specifike të kërkuara nga paragrafët 13C–13E janë kërkesat minimale. Për të plotësuar objektivin në paragrafin 13B, një njësi ekonomike mund të ketë nevojë t'i plotësojë ato me dhënie informacionesh shpjeguese shtesë (cilësore), në varësi të kushteve të marrëveshjeve detyruese për mbrojtjen nga risku i derivativëve dhe marrëveshjeve të ngjashme, duke përfshirë natyrën e të drejtave për kompensim dhe efektin e tyre ose efektin e mundshëm të tyre, në gjendjen financiare të njësisë ekonomike.

## Shtojcë

### Ndryshime në SNK 32 *Instrumentat Financiarë: Paraqitja*

Paragrafi 43 është ndryshuar (teksti i ri është nënvizuar).

- 43 Ky Standard kërkon paraqitjen e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare mbi një bazë neto kur kjo pasqyron flukset e mjeteve monetare të pritshme në të ardhmen të njësisë ekonomike nga shlyerja e dy ose më shumë instrumentave financiarë të veçantë. Kur njësia ekonomike ka të drejtë të arkëtojë ose të paguajë një shumë neto të vetme dhe synon ta bëjë kështu, ajo në fakt ka, një aktiv financiar ose detyrim financiar të vetëm. Në rrethana të tjera, aktivet financiare dhe detyrimet financiare paraqiten veçmas nga njëri tjetri në përputhje me karakteristikat e tyre si burime ose detyrime të njësisë ekonomike. Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 13B–13E të SNRF 7 për njohjen e instrumentave financiarë që janë brenda objektit të paragrafit 13A të SNRF 7.